

Raporti vjetor për vlerësimin e stafit dhe lëndës.

Viti Akademik: 2024-2025

1. Qëllimi i raportit

Ky raport përmbledh rezultatet e vlerësimeve që studentët i kanë bërë stafit akademik gjatë vitit akademik 2024/2025, përmes instrumenteve standarde të sigurimit të cilësisë:

- Pyetësi i vlerësimit të mësimdhënësit

2. Metodologjia

Të dhënat janë mbledhur në mënyrë anonime nga të gjithë studentët aktivë në programet Bachelor, në fund të çdo semestri.

Secila pyetje është vlerësuar në shkallën Likert 1–5, ku 1 nënkupton “Nuk pajtohem fare”, ndërsa 5 “Pajtohem plotësisht”.

Analiza është bërë në nivel lënde dhe mësimdhënësi, dhe më pas është përmbledhur në nivel institucional nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë.

3. Përmbledhje e përgjithshme e rezultateve

Rezultatet për vitin akademik 2024-2025 tregojnë një nivel të lartë kënaqësie të studentëve me cilësinë e mësimdhënies, me një mesatare të përgjithshme institucionale prej 4.7/5.

Të gjitha lëndët dhe profesorët kanë marrë vlerësime mbi pragun minimal institucional të miratimit (nota 4.0).

Fusha e vlerësimit	Mesatarja institucionale	Koment përmbledhës
Prezantimi i syllabus-it dhe qartësia e lëndës	4.7	Studentët vlerësojnë transparencën dhe komunikimin e qartë në fillim të semestrit.
Përgatitja dhe rregullsia e profesorëve	4.8	Mësimdhënësit janë të përgatitur dhe të pranishëm rregullisht.

Fusha e vlerësimit	Mesatarja institucionale	Koment përmblledhës
Përdorimi i metodave bashkëkohore	4.5	Shumë profesorë përdorin mjete digjitale dhe aktivitete interaktive.
Komunikimi dhe respekti ndaj studentëve	4.9	Një nga pikat më të forta të stafit akademik.
Përshtatshmëria e materialeve dhe literaturës	4.6	Studentët vlerësojnë përzgjedhjen e literaturës dhe qasjen praktike.
Qartësia e mënyrës së vlerësimit të studentëve	4.5	Transparencë dhe objektivitet në vlerësim.

4. Interpretimi i rezultateve

Analiza tregon se studentët kanë një perceptim shumë pozitiv për profesionalizmin e stafit akademik dhe për angazhimin e tyre gjatë procesit të mësimdhënies. Pothuajse të gjitha fushat e vlerësuara janë mbi 4.3, që dëshmon për standard të lartë akademik, etikë të punës dhe përkushtim ndaj studentëve.

Një pjesë e komenteve të hapura sugjerojnë nevojën për:

- më shumë shembuj praktikë gjatë ligjëratave;
- shtim të aktivitetit laboratorik dhe ushtrimeve jashtë objektit;
- përdorim më të gjerë të platformave digjitale për materialet e kursit.

5. Përparësitë e evidentuara

Bazuar në analizën narrative dhe statistike, janë identifikuar këto pika të forta:

1. Profesionalizmi dhe përgatitja e stafit akademik – profesorët janë të përkushtuar, të saktë në orar dhe të përgatitur në çdo ligjëratë.
2. Komunikimi efektiv me studentët – vlerësuar si shumë i mirë dhe i hapur, duke nxitur respekt dhe bashkëpunim.

3. Metodatat bashkëkohore të mësimdhënies – përfshirja e diskutimeve, punës në grupe dhe rasteve studimore.
4. Atmosferë pozitive mësimore – mjedis mbështetës dhe motivues për studentët.
5. Përmbytje e azhurnuar akademike – programet janë në përputhje me zhvillimet profesionale në fushat përkatëse.

6. Fushat për përmirësim

Pavarësisht rezultateve shumë të mira, identifikohen disa fusha për zhvillim të mëtejshëm:

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe studentëve në realizimin e vizitave praktike.
- Rritja e vizibilitetit të institucionit përmes mysafirëve special nga Industria.

7. Veprimet e planifikuara për përmirësim

1. Integrimi i komentit të studentëve në procesin e vlerësimit të performancës së stafit.
2. Publikimi i rezultateve përmbljedhëse për transparencë dhe informim të stafit akademik.